

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Vlerësimi i aseteve dhe detyrimeve të OST sh.a.”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

79311410-4 - Vlerësimi i ndikimit ekonomik

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1,860,000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 700,000 (shtateqind mijë) Lekë.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë cilësinë dhe llojin e shërbimit objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me Termat e Referencës të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros së kërkuar të jetë në masën 700,000 (shtateqind mijë) Leke.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.*

*Lidhur me këtë pikë:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetimi të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë cilësinë dhe llojin e shërbimit objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecirë të punës së AK.

---

*2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimumi 5 (pese) punonjës të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

*Per të plotësuar këtë pikë, OE duhet të disponojë listpagesat e-sig për periudhat e kerkuara.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Numri i punonjësve të siguruar është vendosur në përputhje me volumin e shërbimit si dhe afatin e ekzekutimit të kontratës dhe ky numër punonjësish është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me sukses të saj. Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike. Ky kriter është bazuar në nenin 41, pika 4/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë CV të personelit që do të angazhohet për kryerjen e këtij lloji shërbimi nga të cilët të pakten dy prej tyre duhet të kenë kualifikime CPA (Certified Public Accountant, Ekspert Kontabel i Autorizuar) dhe/ose ACCA (Association of Chartered Certified Accountants, Shoqata e Eksperteve Kontabel të Autorizuar), ekuivalenti i IEKA-s së Shqipërisë.*

*Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë për personelin e kualifikuar, certifikata ose diploma që vërtetojnë kualifikimet e kerkuara me siper, si dhe listpagesat, në të cilat*

*duhet te perfshihen ekspertet e sipercituar, te pakten per 3(tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të realizoje shërbimin objekt prokurimi, ne perputhje me Termat e References. Ky kriter është bazuar ne nenin 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i regjistruar ne regjistrin publik te shoqerive te eksperteve kontabel te autorizuar (IEKA).*

*Ne plotesimin e kesaj pike OE ofertues duhet te paraqese nje vertetim nga IEKA, qe te jete i leshuar te pakten 3 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

**Argumentimi:** AK, ka vendosur si kriter regjistrimin e OE-se në regjistrin publik të shoqërive të ekspertëve kontabel të autorizuar pasi "Eksperti Kontabël i Regjistruar" si profesionist i pavarur, i organizuar si Individ apo Shoqëri, e ushtron profesionin vetëm nëse rezulton i regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA). Ky kriter është bazuar ne nenin 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe ne Nenin 77, pika 2, paragrafi i dyte i Ligjit Nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”.

*2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese CV te shoqerise (pershkrim i hollesishem i aktivitetit te shoqerise).*

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të realizoje shërbimin objekt prokurimi, ne perputhje me Termat e References, ka besueshmerine dhe reputacionin per kryerjen e shërbimit objekt kontrate.

*2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i njohur nga Banka Boterore (The World Bank).*

*Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listën e firmave audituese të Bankës Botërore (Eligible audit firms) në të cilën duhet të jetë i përfshirë operatori ekonomik ofertues me statusin Fully Acceptable, ose te paraqese vetedeklarim per permbushjen e kesaj pike. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te ketij vetedeklarimi te OE ofertues.*

**Argumentimi:** Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listën e firmave audituese të Bankës Botërore (Eligible audit firms) në të cilën duhet të jetë i përfshirë operatori ekonomik ofertues me statusin Fully Acceptable. Marrëveshjet e kredive midis Bankës Botërore dhe Njësitve të Zbatimit të Projektit, kanë si kusht që brënda një afati jo më shumë se 6 muaj pas përfundimit të vitit fiskal, pranë Bankës Botërore të paraqiten kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të dhe pasqyra financiare të projektit të përgatitura nga Auditorë të pavarur të pranueshëm nga Banka (full accepted).

Për sa më sipër, kërkojmë që edhe kompania vlerësuese që do të kryejë vlerësimin e aseteve dhe huave me vlerën e drejtë të jetë në të njëjtat standarte dhe e pranueshme nga banka (full accepted).

*2.3.7 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike – Termat e References, jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimin objekt procedure prokurimi, bazuar ne karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".*